

VENDIM
Nr. 816, datë 29.12.2017

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA
DREJTORIA E SHËRBIMIT TË TRUPIT DIPLOMATIK PËR MINISTRINË PËR
EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME, TË PASURISË NR. 1/586+1-2, ZONA
KADASTRALE NR. 8380, TIRANË, PËR T'U PËRDORUR SI SELI E SEKRETARIATIT
TË ZYRËS RAJONALE PËR BASHKËPUNIM RINOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 118/2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor, për ngritjen e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor”, dhe të neneve 901 e vijues, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, për një periudhë të pacaktuar, nga Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, të pasurisë nr. 1/586+1-2, zona kadastrale nr. 8380, Tiranë, sipas planimetrisë bashkëlidhur, për t'u përdorur si seli e sekretariatit të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (ZRBR).

2. Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pasurisë së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

3. Me përfundimin e aktivitetit të ZRBR-së, prona t'i kthehet Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik.

4. Shpenzimet për mirëmbajtjen dhe furnizimin me energji elektrike dhe ujë të zyrave të selisë së sekretariatit të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor i ngarkohen Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

5. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLANIMETRIA E KATIT TE PARE Ap.2
Shkalla 1 : 100

- SIP Apt nr 2 Banese = 187 m2
- SIP Ballkon Apt Nr 2 = 44m2
- SIP Apt nr.2 Banese + ballkon = 231m2
- SIP.BP.SHKALLE+ASHENSOR+KORIDOR = 31m2



